



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni i Posaçëm Për Reformën në Sistemin e Drejtësisë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 14.09.2016, ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të komisionit të datave 17 dhe 23 gusht 2016.
2. Miratimi i kalendarit të punës së komisionit për shqyrtimin e projektligjeve.
3. Vazhdim i diskutimit rreth projektligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Pandeli Majko, Vasilika Hysi, Ulsi Manja, Vexhi Muçmataj, Petrit Vasili, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Keltis Kruja, Jorida Tabaku.

Mungojnë:

Fatmir Mediu dhe Spartak Braho.

Të ftuar:

Gent Ibrahim, ekspert i Nivelit të Lartë

Agnes Bernhard, eksperte e Nivelit të Lartë

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj - (*Mungesë incizimi*) ...miratimin e një draftkalendari të diktuar nga fakti që seanca plenare ka vendosur një kalendar për shqyrtimin e gjashtë projektligjeve, që janë pjesë e paketës së projektligjeve prioritare. Është një draft orientues që të organizojmë punën tonë si komision, por nuk duhet të harrojmë se duhet të organizojmë edhe punën në bashkëpunim me ekspertët vendas dhe ndërkombëtarë, të cilët kanë edhe angazhime të tjera dhe do të duhet të kenë një kalendar, që të mos jetë thjesht diçka e komisionit apo diçka shqiptarësh, e thënë ndryshe, me orar dhe pa orar.

Së treti, edhe për nevojat e organizimit të shërbimeve të punës, që janë përkthimi e të tjera.

Keni përpara një kalendar. Ka komente rreth tij?

Urdhëroni, zoti Bylykbashi!

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, ka një vendim të seancës për kalimin e ligjeve në datë 22 në seancë plenare, por ne gjykojmë se gjashtë ligjet, të cilat vërtet janë ligje kolonë të këtij procesi, kërkojnë një diskutim të mirë, kontribut të përbashkët dhe të miratohen në kohën më të ngushtë të mundshme. Duke ndjekur edhe praktikën e derisotme të Kuvendit, ku data të caktuara nuk kanë qenë ato që kanë dominuar, por ka qenë konsensusi për t'i bërë gjërat mirë, propozoj të rishikohet kalendar i komisionit, që t'i japim kohë të mjaftueshme shqyrtimit të gjashtë ligjeve në komision.

Gjithashtu, ne kemi marrë dje ligje, të cilat janë diskutuar në komision para se të miratohej Kushtetuta, pa praninë tonë. Pa hyrë në diskutim, çështja është se janë bërë modifikime në ligje dhe janë versione të reja, të cilat nuk korrespondojnë me ato të publikuarat dhe për rrjedhojë, është e nevojshme t'i shikojmë. Duke e konsideruar dhe duke vlerësuar se nga gjashtë ligje, të paktën tre kanë prioritet të lart, propozimi ynë, të cilin ia kam dërguar formalisht mbrëmë Kryetarit, është që ta ndajmë këtë kalendar në dy seanca: në datën 22 propozojmë që komisioni të kalojë në seancë tre ligje, që janë: “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, dhe sugjerojmë të shqyrtohet nesër në komision, pra në datën 15. Në datën 16, ditën e premte, të jetë projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8577 të vitit 2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Ditën e hënë, në datën 19 të jetë projektligji “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Në

gjykimin tonë, nga gjashtë ligje të rëndësishme, këto kanë një prioritet më të madh dhe jemi të gatshëm që në këto tri ditë, për t'i dhënë mundësi edhe ekspertëve të opozitës, të shqyrtojmë këto që kemi punuar dhe tri ligjet e tjera të shqyrtohen në datën 29 me kalendarin e propozuar, që projektligji “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” të shqyrtohet nga komisioni në datën 23 shtator, të premten, dhe në datën 26 shtator, të hënën, të shqyrtohet projektligji “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Ditën e martë, në datën 27, në kohë të mjaftueshme për ta përcjellë në seancë, të shqyrtohet projektligji “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Besoj se është kohë e mjaftueshme për të gjithë ne për të bërë një punë dhe për ta përmbyllur këtë aspekt të rëndësishëm të punës së komisionit, por duke dhënë hapësirën e mjaftueshme për t'i shqyrtuar dhe për të parë edhe ndryshimet eventuale që janë bërë në këto projektligje.

Para se të mbyll propozimin për ndryshimin e projektkalendarit, dua të theksoj se ligjin “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, duke qenë se është shumë i rëndësishëm, është voluminoz, impaktohet nga Kushtetuta dhe ne jemi duke punuar për ta përmbyllur, nga dita e sotme, në çdo rast, të spostohet për ditën e hënë, ku të fillojmë me diskutimin e plotë për ta përmbyllur.

Siç ju thashë, e kam dërguar dje këtë propozim dhe sugjeroj që komisioni ta marrë në konsideratë, që të punojmë në mënyrë më efikase të mundshme. Janë gjashtë ligje shumë të rëndësishme. Të shtyhem me nxitim, thjesht për t'i kaluar formalisht, nuk besoj se na ndihmon. Kërkoj mirëkuptimin tuaj, të nderuar kolegë, për të arritur në këtë modus pune të komisionit në dy javët e ardhshme.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Bylykbashi!

Ka komente nga kolegët e komisionit?

Urdhëroni, zoti Vasili!

Petrit Vasili – Unë mendoj se sot jemi në një moment pozitiv, që jemi të gjithë në tavolinë. Sigurisht, kjo eviton një mundësi më të mirë diskutimi, që ne mund ta kishim pasur edhe për ligjin e vetingut, që i parapriu kësaj pakete, por megjithatë, nuk ka asnjë problem, rëndësi ka të ecim përpara.

Me vetingun kishim një imponim të rëndësishëm, që kishte të bënte me çështjen e ecurisë së procesit të integritetit dhe sigurisht që ishim në një krizë kohe pozitive, do të thosha, sepse kishte të bënte me një objektiv tjetër.

Mendoj se ajo që paraqiti zoti Bylykbashi, në qoftë se është një impenjim, të cilit i qëndrojmë, sepse ne këtu bëjmë marrëveshje fjalësh, jo noteriale, kohët janë të arsyeshme,

pasi një pjesë e drafteve kanë pasur përpunim të vazhdueshëm dhe versionet përfundimtare vërtet janë kthjelluar në momentet e fundit. Duke filluar punë që nesër, them se mund t'i përdorim edhe kohët para ose gjatë seancës, sepse është detyrim madhor. Besoj se ne jemi në kohën e duhur dhe i krijojmë mundësi vetes të krijojmë një diskutim të përbashkët. Unë bëj pjesë tek ata që kanë optimizëm, që duhet të ecim përpara duke pasur një dakordësi shumë më të mirë, sepse në elementet themelore parimore e kemi këtë dakordësi dhe nuk pengohemi të arrijmë, sepse sa më shumë marrëveshje të kemi, aq më mirë i bën procesit.

Të them të drejtën, mua më duket një kalendar i arsyeshëm, pasi ne nuk kemi detyrim që na kufizon në mënyrë absolute, apo lëviz me një javë, apo njëri nga ligjet ka prerogativat e vetingut. Për vetingun kam qenë plotësisht i motivuar kur e kemi kaluar, kur e kemi votuar dhe kur e kemi votuar jo në mënyrë të njëanshme, por në shumicën kushtetuese të domosdoshme për pjesëmarrjen e opozitës dhe, sigurisht, nuk jam bërë pishman dhe nuk bëhem. Por, në ligjet që kemi përpara, me këtë kalendar, brenda ditës së sotme, që është e mërkurë, duhet të shterojmë tri ligjet, të cilat duhet t'i kemi gati të hënën, siç është ligji "Për qeverisjen", "Për prokurorinë e posaçme", "Për SPAK-un" dhe "Për Gjykatën Kushtetuese", kemi hedhur një hap përpara dhe ideja që shtatë ligjet ne i kemi të shteruara brenda datës 29. Unë shpresoj, për aq sa dëgjova nga zoti Bylykbashi, të ecim në rrugën e duhur që të kemi një mirëkuptim të gjerë dhe nuk gjej arsye për të mos pasur një rimodifikim të kalendarit, që është një nismë shumë pozitive, sepse falë tij zoti Xhafaj na ka orientuar mjaft mirë se ku duhet të ecim. Modifikimi për disa ditë më pak apo më shumë nuk e prish thelbin e gjësë, të paktën në opinionin tim. Por marrëveshja e fjalës është kjo: do t'i qëndrojmë strikt këtij kalendarit dhe në rast se dikush lëviz kalendarin, legjitimohet në mënyrë të plotë nga ana politike dhe të ecim edhe në mënyrë të njëanshme për të arritur këtë axhendë, që të realizohet në mënyrë të plotë. Ky është mendimi im personal për ato që dëgjova këtu.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Keni gjë tjetër?

Oerd Bylykbashi – Mundem?

Fatmir Xhafaj – Çfarë kuptimi ka që pas çdo kolegu të bëjmë debat?

Oerd Bylykbashi – Mirë, por...

Fatmir Xhafaj - Dakord, por mos e bëni vijë këtë, sepse nuk ka kuptim.

Oerd Bylykbashi – Unë besoj se fryma ndërtohet edhe me gjëra të vogla kur punojmë këtu, edhe kur flasim dhe bëjmë batutë me mikrofon. Zoti Vasili, është një propozim konkret zyrtar nga ana jonë, që bazohet në arsye teknike, të cilat kanë nevojë që të gjithë ne të jemi të gatshëm. Kështu është ndërtuar ky proces, ka shkuar deri në fund. Të

paktën, pjesët e mira që mund t'i shpëtojmë, t'i shpëtojmë. Është propozim zyrtar: deri në datën 29 ne i mbyllim. Tri ligjet e para në datën 22 dhe tri ligjet e tjera në datën 29. Besoj se ky komision ka bërë një punë të madhe për reformën në drejtësi. Mirë, apo keq, ta gjykojnë të tjerët, por të paktën të japim kontribut të saktë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ka komente të tjera rreth kësaj çështjeje? Nuk ka.

Unë pata rastin të flas paraprakisht për këtë çështje. E kam marrë edhe propozimin e zotit Bylykbashi për risistemimin e brendshëm të kalendarit. E thashë në fillim që është një kalendar orientues, diktohet nga kalendari i përcaktuar nga seanca plenare dhe ne jemi të detyruar ta respektojmë. Natyrisht, këto nuk janë afate që në praktikën parlamentare nuk janë zhvendosur, por duhet të kemi vëmendje që, na pëlqen apo nuk na pëlqen, e quajmë të mirë apo të keq, ku ndahemi se cila është e mira apo e keqja, një gjë është shumë e rëndësishme, që pritshmërinë e opinionit publik, pritshmërinë e partnerëve, por edhe pritshmërinë e organeve ligjzbatuese për miratimin sa më shpejtë të kësaj pakete prioritare ligjesh janë tejet të rëndësishme për arsye të njohura dhe të panevojshme për t'i bërë pjesë të debatit në këtë moment.

Mendoj se ka qenë kohë e mjaftueshme për të njohur ligjet, frymën e ligjeve dhe parashikimet në ligj. Të paktën ligjet kanë rreth tre muaj që janë depozituar dhe janë bërë publike. Dy ligjet: “Për qeverisjen”, “Për organet e qeverisjes në sistemet e drejtësisë” dhe ligji “Për SPAK-un”, konkretisht janë vënë në dispozicion që nga data 16 gusht që për të pasur një *feedback*, për të pasur një opinion të kolegëve të opozitës bashkë me ligjin e vetingut, që është miratuar. Kështu që koha ka qenë e mjaftueshme.

Gjithsesi, jam shumë dakord me atë që parashitroi edhe kolegu Vasili, që në funksion të nevojës për ta kalendarizuar gjënë, por edhe në funksion të nevojës për të pasur sa më shumë kontribute në këtë tavolinë dhe në funksion të procesit, këto nuk janë tabu që nuk ndryshojnë, apo janë gjëra të prera me thikë, por nuk është e lehtë ta bësh një kalendar në kushtet që ne nuk jemi të vetëm. Edhe kur bëjmë kalendarin në Komisionin e Ligjeve, duhet të merremi vesh paraprakisht me insionet propozues që të dakordësojmë në kohë, në organizim e të tjera. Duke i pasur parasysh, mendoj ta miratojmë kalendarin në parim duke reflektuar për një pjesë të mirë të gjërave që u thanë këtu, të vazhdojmë me projektligjin “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” për aq sa të kuptojmë sa kanë reflektuar deri tani pa filluar shqyrtimin, të presin të fillojë shqyrtimi më saktë ditën e hënë, siç u propozua. Zonja Agnes është prezente, të dakordësohemi me misionin Euraliu-s, që është i përfshirë, dhe ta bëjmë të hënë si proces. Edhe opozita është e gatshme për këtë ditë.

Ndërkohë, të vazhdojmë nesër me ligjin për SPAK-un, por me ndryshimin që ligjin e Gjykatës Kushtetuese nuk e bëjmë dot të premtën, por do të bëjmë ligjin e prokurorisë.

Pse do të bëjmë ligjin e prokurorisë dhe për këtë insistoj? Për arsyen e thjeshtë, se edhe ekspertët e kanë të vështirë për javën që vjen, por nuk është kjo kryesorja. Kryesorja është, sepse ato janë ligje që shkojnë me njëra-tjetrën, dhe zhvendosja në kohë mund të na krijojë probleme. Nëse ka diçka që nuk plotësohet nesër dhe pasnesër, ne mund t'i lëmë kohë të lirë vetës për ta riparë në një apo dy gjëra në një moment të dytë. Të hënën vazhdojmë me ligjin për qeverisjen, ligjin për organizimin e pushtetit gjyqësor, pra të tria ligjet e pjesës së gjyqësorit, sepse ato janë harmonike me njëra-tjetrën në terminologji, referenca dhe çdolloj shprehje do të krijonte probleme. Kjo ka qenë arsyeja që kemi dashur t'i bëjmë bashkë. Në fund farë, le të lëmë ligjin për Gjykatën Kushtetuese, i cili është edhe më i thjeshtë, por që nuk është i ndërvarur nga dy paketat.

Pra, kemi dy paketa. Kemi paketën e drejtësisë penale, apo të prokurorisë, po e quaj më thjeshtë, dhe paketën e gjyqësorit. T'i bëjmë bashkë këto paketa, në mënyrë që të kenë koherencë në shqyrtim, në terminologji dhe në angazhim, pastaj brenda përbrenda mund të bëjmë ndonjë lëvizje, kështu që edhe opinioni i opozitës është i përfshirë.

Po.

Oerd Bylykbashi - Zoti kryetar.

E vlerësoj që ka një hapje drejt arsyes mbi atë që ne propozuam. Unë e kuptoj shumë mirë këtë dhe në parim jam dakord që këto janë disa ligje që e kanë një ndërlidhje, siç është ligji i prokurorisë me ligjin e SPAK-ut, por nuk besoj se jemi duke bërë një proces aq të madh kaq të shkurtër në kohë. Ne këtu jemi duke i harmonizuar këto gjëra. Për arsye që janë të karakterit fare teknik, kjo është arsyeja se pse ne po i shtyjmë në kohë, ku ligjin e prokurorisë për shembull, po e shtyjmë në kohë për në seancën e datës 29. Frika e madhe që ekziston, që ne mund humbasim koherencën e terminologjisë midis dy seancash, besoj se në themel nuk qëndron, por ndoshta mund ta diskutojmë për ditën e martë.

Pra, të marrim pak kohë. Ditën e premtë operojmë me ligjin e Gjykatës Kushtetuese, që ne jemi të gatshëm ta ezaurojmë dhe ditën e martë, të kenë pak kohë ekspertët për të parë këtë ligj që ne na ka ardhur dje në versionin e fundit, për të parë, se cilat janë detajet që kanë lëvizur, sepse siç e tha edhe zoti Vasili, ndoshta janë vazhduar, përpunuar dhe përmirësuar formulimet. Këtë diskutim ta bëjmë ditën e martë, nëse është në merakun tuaj që duhet patjetër të kalojë në një seancë të vetme. Unë atë rrezik realisht nuk e shikoj, por të vijmë në një rrugë të mesme. Pra, është arsye fare teknike, kjo që ne do të donim që të ishte më vonë ligji i prokurorisë. Të marrim kohën minimale për ta parë.

Dua të jem më i qartë. Ndërkohë, sot ju propozuat fillimin e një diskutimi për ligjin “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, por cila ishte ideja kryetare? Edhe një herë.

Fatmir Xhafaj - Së pari, insistoj që diskutimi për ligjin e prokurorisë të hapet të premtën. Po të jetë e nevojshme, njerëzit tuaj le të punojnë edhe më me shumë ngarkesë, por të premtën të hapet që e gjithë paketa të jetë bashkë. Nëse nuk përfundon, unë jam i hapur për të vazhduar, në qoftë se ju do të kërkon kohën e nevojshme për çështje të caktuara, por nëse e përfundojmë është shumë mirë për të dyja palët.

Për sa i përket ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, ideja ime është kjo: zonja Hysi, pasi është paraqitur paketa, në cilësinë e relatores, i ka paraqitur një opinion me disa komente autorëve të projektit. Gjithashtu, zoti Vasili, ashtu si dhe zonja Hysi, i ka paraqitur një dokument me shkrim autorëve të projektit. Meqenëse janë këtu, le të shikojmë se cili është reflektimi nëse kanë diçka. Pastaj, ato i keni edhe ju në dispozicion, mund t’i merrni, dhe keni mundësi deri të hënën t’i shikoni se çfarë komentesh kanë bërë kolegja Hysi dhe kolegu Vasili, sepse mund t’ju ndihmojnë edhe ju që të mos përsërisni gjëra që mund t’i kenë thënë kolegët. E para kjo.

Së dyti, është e rëndësishme që t’i kundërshtoni dhe të jeni më të gatshëm nëse nuk pranoni gjëra që mund t’i kenë thënë ata, t’i paraqisni.

Oerd Bylykbashi – Për seancën tjetër?

Fatmir Xhafaj – Jo, nga data 16 gusht nuk ka pasur seancë për këto. Janë gjatë kësaj kohe, siç duhet të sillnit ju...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po mirë pra, ja kanë dhënë atyre. Prandaj po them edhe unë, që ata do japim reflektimin. Pastaj i merrni edhe ju këto dhe...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Patjetër. Jemi dakord?

Jorida Tabaku - Shqetësimi është që jemi ndodhur në të njëjtën pozitë edhe herë të kaluara. Janë prezantuar diskutime nga ana juaj, dhe kur ka qenë radha që ne të prezantojmë komentet tona, keni thënë që e kemi ezauruar këtë fazë dhe i kemi diskutuar një herë këto nene. Unë besoj se të gjithë kolegët këtu, janë dakord, që kjo praktikë pune në herët e kaluara, na ka penguar që në një fazë të dytë ne të prezantojmë punën tonë. Sigurisht, normalja është që të mos kemi përsëritje dhe të dëgjojmë zonjën Hysi, sepse mund të kemi çështje të përbashkëta, por eksperiencia e kaluar me këtë komision nuk ka qenë pozitive që ne ta marrim me mirëbesim sugjerimin tuaj.

Fatmir Xhafaj - Unë ju falënderoj që morët fjalën, zonja Tabaku, por nuk jam fare dakord me ju. Do t'ju lutesha që të gjenit një procesverbal të vetëm, ku është thënë kjo gjë dhe unë personalisht do t'ju kërkoja ndjesë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Edhe një herë: në asnjë rast nuk kemi penguar që t'u jepet mundësia kolegëve të opozitës të shprehen. Në asnjë rast. Jemi kthyer pas, kemi shkelur procedurën formale, unë dhe kolegët e kemi bërë këtë gjë, por më gjeni një rast që ka ndodhur kjo gjë dhe unë do ju kërkoj ndjesë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord. Jeni e lutur që të ma gjeni këtë rast.

Nuk besoj, se të gjithë ne që folëm, qoftë zoti Bylykbashi, zoti Vasili që orientoi diskutimin në këtë pikë dhe unë që e mbështeta, nuk thamë të kundërtën. Përkundrazi, thamë që po e bëjmë të thjeshtë që të kuptojmë se çfarë qëndron dhe çfarë nuk qëndron, edhe për respekt të kësaj seance që kemi vendosur këtu. Kjo është në favorin tonë, në favor të zotit Vasili, në favor të zonjës Hysi, në favorin tim dhe në favorin tuaj që të kuptojmë, me qëllim që të hënën të jemi akoma më të përgatitur gjatë kohës që do të diskutojmë, si dhe atyre t'u jepet mundësia të reflektojnë. Kaq. Është e thjeshtë.

Po, zoti Bylykbashi.

Oerd Bylykbasi – Zoti kryetar.

Unë vazhdoj t'i mbetem idesë që propozimi ynë është propozim fare racional. Gjeta pjesërisht mirëkuptim nga ju, por gjeta mirëkuptim edhe nga zoti Vasili. Edhe një herë bëj thirrje që të ecim, sepse nuk besoj se ekziston asnjë lloj risku që ne të konfuzionojmë terminologji dhe të krijojmë inkoherenca midis ligjeve.

Fatmir Xhafaj - Nuk e kuptoj dot. Të dëgjojmë ata se çfarë problematikash ka krijuar.

Oerd Bylykbashi - Jo, e kam fjalën për prokurorinë. Besoj se shtyrja për në datën 29, ne nuk na cenon. Është bërë pjesa më e madhe e punës dhe në qoftë se e keni bërë gabim terminologjinë, nuk do të merremi fare me të, mbajeni vetë përgjegjësinë. Kur ne bëjmë propozimet te ligji i vetingut për të saktësuar gjuhën, ju nuk i pranuat. Është puna juaj.

Shqetësimet tona janë kryesisht të karakterit thelbësor dhe me ato do merremi. Nuk doni të keni cilësi ligji? Është problemi juaj, sepse me votat tuaja do të miratohen ato ligje. Është kërkesë minimale, na ka ardhur dje e shtyjme për seancën tjetër. E para kjo.

Së dyti, shqetësimi i zonjës Tabaku qëndron, sepse në fakt, ka ndodhur dhe na është dashur një debat i madh për t'u rikthyer nëpër nene, sepse ky komision nuk ka funksionuar

kurrë me mirëbesim dhe mirëkuptim, gabim i rëndë për mendimin tonë, por gjithsesi kemi ardhur këtu, prandaj ta mbyllim këtë çështje. Çfarë rëndësie ka. Sot, fundja meqë janë ngritur çështje, do të dëgjojmë një koment nga ana e ekspertëve, se sa janë reflektuar ato. Ky është propozimi juaj.

Sigurisht që, do donim që të kishim edhe ne mundësinë që t'i ngremë këto shqetësime dhe të shikojmë se çfarë do të thonë ekspertët për shqetësimet tona, ndaj po kërkojmë kohë minimale deri ditën e hënë.

Edhe një herë: unë sugjeroj që, fundja po të jetë kështu, ne ta votojmë këtë propozim tonin. Kemi bërë një propozim formal, nuk na prish punë, nuk është këmbëngulje pa arsye dhe i shikojmë gjërat me kthjelltësi.

Fatmir Xhafaj - Jua thashë pra, ne e zhvendosëm të gjithë kalendarin me logjikën e propozuar nga ana juaj dhe nuk kam ndonjë merak të veçantë për këtë gjë, sepse është në funksion të nevojës që kemi për të qenë të gjithë bashkë këtu, por natyrisht edhe në funksion të cilësisë. Ju thashë që do ta hapim të premtën, por nëse ju nuk jeni gati dhe kërkon më shumë kohë, do t'ua japim këtë mundësi.

Po.

Petrit Vasili - Për të qenë racional, sepse na duhet të ecim me këtë punë, ne duhet që t'i vëmë gjërat njëra pas tjetrës që të bëjmë përpara. Besoj se jemi dakord që kemi afat nga data 22 deri në datën 29, dhe sigurisht që do i kërkojmë mendimin konferencës së kryetarëve për të bërë modifikimet në kalendar. Apo jo? Besoj se jemi dakord?

Në momentin që ne kemi arritur një mirëkuptim të rëndësishëm për këtë punë, unë jam i mendimit që modifikimet e kalendarit, ne t'ia besojmë zotit Bylykbashi dhe zotit Xhafaj. Pastaj, se si do të forcohet njëra apo tjetra palë, në përputhje me afatin e ri, është një çështje tjetër, por ama fitohet një mirëkuptim i madh që i dhamë kohë vetes për të diskutuar gjërat. Prandaj, unë them që është e kotë të shpenzojmë kohë. E rëndësishme ishte që të dilnim nga ky ngërç, pastaj a është një ligj që duhet parë më pas dhe një ligj më parë, le të lodhemi pak më shumë, por të paktën të kemi hapësirën e duhur.

Fatmir Xhafaj - Dakord. Biem dakord në parim dhe kështu ecim hap pas hapi.

Faleminderit të gjithëve për mirëkuptimin!

Vazhdojmë me projektin. Do bëni një...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do ta lëmë kështu dhe pastaj do merremi vesh edhe me ekspertët që kemi apo nuk kemi mundësi, ndërkohë ju do të bëni të gjithë sforcën e nevojshme që të ecim përpara.

Oerd Bylykbashi – Kryetar, e lëmë kështu dhe në fund fare supozojmë që nuk ndryshon. Në parim ne nuk biem dakord për këtë kalendar.

Fatmir Xhafaj – Dakord, mos bini dakord, se do të bini kur ta lexoni.

Oerd Bylykbashi - Dakord. Edhe një herë. Ne propozojmë, që nesër të diskutojmë për SPAK-un, të premtën për Gjykatën Kushtetuese, të hënën bëjmë ligjin e organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, si dhe diskutojmë në maksimum mundësinë për ta bërë ditën e martë ligjin për prokurorinë.

Pra, e tërheqim pak më përpara. Po qe se nuk ia dalim dot, me mirëkuptim, mund të vendosim që ta shtyjmë për në seancën tjetër. Ta ndajmë këtë dhe të paktën parimi të jetë mbi këto parametra.

Fatmir Xhafaj – Si paketa penale, ashtu edhe paketa për gjyqësorin do të kalojnë bashkë. Nuk mund të jetë ndryshe dhe nuk e pranon as logjika e procesit që të jetë edhe në komision edhe në seancë, por natyrisht, do të ketë një lloj fleksibiliteti. Nëse ju nuk do të jeni të gatshëm për të premtën, do flasim bashkë, do flas edhe me ekspertët ndërkombëtarë, sepse mund të mos jenë të martën. Do të zhvendosim një gjë, do të merremi vesh, sepse me kë do ta bëjmë komisionin, në qoftë se nuk janë ekspertët në tavolinë? Me njëri-tjetrin? Pastaj do të themi... Do rakordojmë me ta dhe do të vendosim, sepse tani dolën këto gjëra.

Petrit Vasili - Ne kemi rënë dakord që të ketë ndryshim kalendari. Të gjithë jemi të qartë se e gjithë paketa, siç ka qenë e planifikuar e tëra, të kalonte në datën 22, por nuk e kalojmë dot. Këtu jemi të qartë.

Oerd, unë besoj se kjo është një çështje fleksibiliteti si shumë gjëra, dhe në rrugë e sipër ka ndryshuar, por ama kemi një kohë të re, datën 29, që është e kapërcyeshme. Kjo është dakordësia që kemi këtu, dhe brenda kësaj date ne e kemi dhënë. Besoj se edhe kolegët janë të një mendimi, rakordojuni me zotin Xhafaj dhe në bashkëpunim me ekspertët ndërkombëtarë, dhe po u desh që të gdhihemi një natë le ta bëjmë, sepse nuk na gjen gjë. Në fund të fundit, të gjithë jemi mësuar që kemi punuar edhe nga 14 orë. Le të rrinë ta shikojmë, sepse nuk janë kaq jofamijarë me ligjet. Po qe se duhet...

Edhe pretendimi i zotit Xhafaj është i arsyeshëm, që, meqë këto kanë një ndërvarësi të madhe, siç është pjesa penale, le të lodhemi pak më shumë. Gjysmën e projektligjit do ta shikosh ti, gjysmën e shikon Gazi, gjysmën tjetri, gjysmën Beni. Nuk është ndonjë gjë, sepse të gjithë kemi punuar. Përderisa kemi fleksibilitet, do të thotë që të gjitha palët, jo thjesht lëshojnë, se nuk është ndonjë lëshim i madh, por rimodelojmë punët sipas një dakordësie të re që i dhamë kohë dhe mundësi vetes edhe një javë për të qenë të gjithë bashkë për ta diskutuar.

Ne kemi mirëkuptim të plotë, gjejini, rregullojini si të doni punët me njëri-tjetrin brenda kësaj kohe të re dhe ne na keni në mirëkuptim si dhe ekspertët tanë do jenë në varësi të axhendës që do përcaktoni ju. Besoj se kjo është maksimalja për mendimin tim.

Fatmir Xhafaj – Po, faleminderit!

Ka komente të tjera? Jeni dakord?

Dakord, faleminderit!

Atëherë, vazhdojmë me ligjin “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Kush do ta bëjë prezantimin, ju dhe zoti Vasili, apo ju tek të dyja?

Po, zoti Vasili.

Petrit Vasili – Unë i kam parë komentet dhe reflektimin e tyre dhe që të mos i marr kohë mbledhjes, bisedova me zonjën Hysi, shumica janë ezauruar, por në qoftë se kam diçka të paqartë, të hënën kur të fillojë shqyrtimi, do ta paraqes atje. Për shumicën jam i kënaqur nga mënyra sesi janë reflektuar.

Fatmir Xhafaj – Shumë faleminderit, zoti Vasili!

Zonja Hysi, shkurt besoj, sepse s’ka kuptim.

Vasilika Hysi- Faleminderit, zoti kryetar!

Është thjesht për të informuar edhe kolegët e opozitës, meqenëse nuk kanë qenë në komision.

Unë para se të gjithash do të doja të falënderoja shumë ekspertët vendas dhe ndërkombëtarë, të cilët kanë reflektuar të gjitha diskutimet që ne kemi bërë nen për nen në lidhje me projektligjin, përveç dy çështjeve që janë lënë të hapura, për të cilat bën sens tani që kemi edhe kolegët e opozitës.

Në përgjithësi janë reflektuar ndryshimet që nuk lidheshin me Kushtetutën.

Së dyti, janë rregulluar të gjitha nenet e lëna hapur, në varësi edhe të marrëveshjes së 21 korrikut të vitit 2016. Pra, kanë gjetur reflektim në përputhje me ndryshimet kushtetuese, njëkohësisht kanë gjetur reflektim edhe komentet e kolegut Vasili, lidhur me projektin për organet e qeverisjes.

Një nga çështjet risi, që kolegët e opozitës ndoshta e kanë parë, është se fillimisht ishte menduar që Shkolla e Magjistraturës të rregullohej me ligj në vete, por gjatë diskutimeve në komision, kemi pasur një debat shumë të frytshëm dhe e integruam si pjesë të kapitullit të organeve të qeverisjes, për dy arsye shumë të thjeshta.

E para, pjesa më e madhe e veprimtarisë së Shkollës së Magjistraturës rregullohet me ligjin e statusit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, pra me një ligj që votohet me 3/5-at dhe ngelin shumë pak elemente të tjera që të rregulloheshin me një ligj të veçantë. Në këtë

kuadër, meqenëse te veprimtaria e Shkollës së Magjistraturës një pjesë rregullohej me ligjin e statusit të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe një pjesë rregullohej me ligjin për qeverisjen, mbetej shumë pak për të pasur një ligj në vete. Kjo është reflektuar, edhe më parë ne kemi bërë komente mbi këtë kapitull dhe shoh që janë reflektuar edhe në variantin që ka depozituar grupi i ekspertëve.

Gjithashtu, në këtë projekt janë reflektuar edhe komentet e EURALIUS-it, edhe EURALIUS ka pasur komente gjatë diskutimeve ose pyetjeve që ne kemi parashtruar dhe unë shoh që një pjesë e komenteve, e pyetjeve, ose e sqarimeve janë reflektuar. Në shumicën e rasteve kanë qenë sqarime dhe saktësime që i patëm si me anëtarët e komisionit, ashtu edhe me EURALIUS-in. Ajo që dua të theksoj, për ju kolegë, është që ligji ka rregulluar në mënyrë shumë të detajuar procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve, me qëllim që të respektohet rekomandimi që bën Komisioni i Venecias, për të pasur një proces nominimi, pluralizmi, transparencë, objektivitet dhe kritere shumë të qarta dhe kjo është bërë në mënyrë të qartë.

Kemi pasur disa nene dhe ju e keni parë besoj, sepse edhe ju keni punuar me projektin gjatë muajve korrik-gusht, që ka një përsëritje të procedurave në përzgjedhjen e kandidatëve. Kemi pasur një diskutim me kolegët ekspertë, nëse mund të përmblihdeshin apo të shkurtoheshin për ta bërë ligjin më ekonomik ose jo. Me të drejtë, unë e gjej me vend faktin që ata nuk e kanë pranuar atë sugjerim, ose atë pyetje që unë parashtrova, me qëllim që të bëhet e qartë se për çdo lloj kandidature, që kërkon Kushtetuta dhe konkretisht neni 147, paragrafi i katërt i ndryshimeve kushtetuese, i ligjit nr.138, që të jetë e qartë për çdo institucion.

Gjithashtu, ne në komision kemi diskutuar se si të jetë sa më transparent procesi i funksionimit të KLGJ-së dhe të KLP-së, por njëkohësisht edhe për të shmangur konfliktin e interesave, nisur nga problematika që është konstatuar, kur anëtarë të komisionit, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, pra, të KLGJ-së së ardhshme, votonin dhe promovonin veten e tyre. Në përputhje me legjisllacionin për parandalimin e konflikt të interesit, me rekomandimet e dhëna nga ekspertët e EURALIUS-it, por edhe nga diskutimet që ne kemi bërë, edhe ky kapitull është pasqyruar dhe reflektuar qartë. Pra, çdokush i ka të qarta çështjet e konfliktit të interesave. Shumica e komenteve dhe diskutimeve, që kemi bërë në komision gjatë diskutimit të këtij projektligji, kanë qenë më tepër probleme të gjuhës, të teknikës legjisllative dhe të terminologjisë, të cilat tashmë janë të rregulluara, të unifikuara si terminologji. Pa dyshim, që në qoftë se gjatë diskutimeve ka ndonjë term, ose ndonjë gjë që ka shpëtuar, unë e quaj më se normale që mund të rregullohet, aq më tepër që këto janë çështje redaktoriale.

Zoti kryetar, këto janë në përgjithësi.

Dua të them edhe dy fjalë edhe për çështjet që ka ngritur, zoti Vasili.

Fatmir Xhafaj – S’ka rëndësi, se i tha edhe zoti Vasili.

Vasilika Hysi – Në të gjithë diskutimin, zoti Vasili ka ngritur rolin e Ministrisë së Drejtësisë dhe donte disa argumente se pse duhet të ishte Shkolla e Magjistraturës në këtë ligj. Këto kisha, s’kam gjë tjetër.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Po, zoti Ibrahim.

Gent Ibrahim- Edhe unë do të flas fare shkurt. I njëjti proces ka ndodhur edhe në raport me EURALIUS-in. Megjithëse EURALIUS-i është bashkautor i këtij projektligji, në fund teksti është shkruar në shqip, kështu që atyre u është dashur të verifikojnë edhe saktësinë e reflektimit të kontributeve të tyre, si edhe të sjellin kontribute shtesë. Gjatë muajit gusht ka pasur tri burime komentesh dhe rekomandimesh nga zonja Hysi, zoti Vasili dhe nga EURALIUS-i. Shumë shkurt komentet e EURALIUS-it konsistojnë si më poshtë:

Një përpjekje për të harmonizuar, aq sa është e mundur, konceptet dhe terminologjinë midis tri ligjeve që përbëjnë paketën e gjyqësorit, pra të ligjit për organizimin e pushtetit gjyqësor merret projektligji për statusin e gjyqtarit. Një përpjekje për të ndërtuar një institucion të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i cili është i centralizuar, ashtu siç e urdhëron Kushtetuta, por sidoqoftë, nuk degradon deri në arbitraritet. Do ta vini re që projektligji ka disa zgjidhje shumë të kujdesshme, të cilat, natyrisht e respektojnë urdhërimin kushtetues për një organ monokratit në rastin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, por nga ana tjetër, në shumë momente ka një përpjekje për ta zbutur pushtetin e individit, duke krijuar komitete të ndryshme brenda inspektoratit.

EURALIUS-i ka dhënë sugjerime shumë të vlefshme për të zgjidhur problemin teknik të vlerësimit tekniko-profesional të atyre magjistratëve që shërbejnë për 5 vjet në Këshillin e Lartë Gjyqësor, apo në Këshillin e Lartë Prokurorial, ka dhënë rekomandime në lidhje me një situatë hipotetike, që mund të krijohet në momentin e krijimit të këtyre këshillave, kur gjyqtarë, apo prokurorë të niveleve të ndryshme, nuk preferojnë të kandidojnë për të zënë vendet që u takojnë në këshilla. EURALIUS-i ka dhënë këshilla shumë të vlefshme për rafinimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve nga grupet e profesionistëve. Ai mban autorësinë e një sistemi kontrolli të vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në lidhje me vendimet për pushimin ose mosfillimin e inspektimeve, në rast se vihet e pa kontrolluar, kjo është një mundësi arbitrariteti, gjë që e kemi parë në rastin

të funksionimit të organit të prokurorisë. Kështu që, falë ideve të EURALIUS-it, ne kemi zgjidhje optimale në këtë pikë. EURALIUS-i, ka sugjeruar pasurimin e kriterëve për pozicionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka ndihmuar edhe në racionalizimin e proceduarave të veprimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, duke krijuar një dallim të qartë midis procedurave që kanë të bëjnë me vlerësimin e kushteve ligjore dhe me vlerësimin e aftësive etiko-profesionale të kandidatëve. Së fundi, EURALIUS ka ndihmuar për të racionalizuar dhe përmirësuar dispozitat tranzitore, të cilat në një projektligj madhor si ky dhe në kontekst të një reforme kaq të gjerë si kjo, siç mund ta imagjinoni, janë të një rëndësie jetike.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ka ndonjë koment tjetër?

Oerd Bylykbashi – Në lidhje me këtë, bazuar edhe në çfarë diskutuam më herët dhe që ramë dakord për kalendarin, të gjitha komentet tona, përfshirë edhe shqetësimet e ngritura nga kolegët, reflektimin e bërë nga ekspertët, përfshirë edhe komentet e tyre, do të jenë në seancën kur do ta shqyrtojmë këtë ligj. Pavarësisht se çfarë u tha sot, ne i rezervojmë komentet tona për çdo lloj problemi që do të konstatojmë në seancën e shqyrtimit të ligjit nga komisioni.

Fatmir Xhafaj – Ju i keni të draftuara, përfshirë edhe këto?

Gent Ibrahimi – Ne kemi një dokument pune tonin, ku i kemi reflektuar me grupin parlamentar. Në rast se do ta kërkonte, e bëni ju dokument parlamentar. Na duhen edhe disa orë punë.

Fatmir Xhafaj – A mundet që kur ta bëni, ne t’i kemi përpara që të kuptojmë se si ishte dhe si janë përfshirë,

Gent Ibrahimi –Po, patjetër!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Meqenëse ata i kanë reflektuar, mund t’i kemi edhe ne.

Po, zoti Bylykbashi!

Oerd Bylykbashi – Meqenëse ky ligj po diskutohet për herë të parë në mënyrë kushtetuese nga ky komision, për shkak se herën e parë është diskutuar para se kushtetuta të hynte në fuqi, pra, edhe si iniciativë nuk e kishte bazën kushtetuese, kjo është diçka e kaluar, por gjithsesi duhet thënë, pa bërë asnjë koment më pas unë vetë, pyetja ime është nëse ju keni konstatuar ndonjë problematikë antikushtetueshmërie, ose në mospërputhje me Kushtetutën në germë dhe në frymë nga ky projektligj që ka përpara sot komisioni? Pra mendoni që janë

reflektuar të gjitha çështjet, ose zgjidhjet kushtetuese që u dhanë në amendamentet që u bënë në datën 22 korrik?

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Ibrahim!

Gent Ibrahim – Në fakt, detyra jonë kryesore dhe e para, ka qenë reflektimi i ndryshimeve kushtetuese.

E dyta, ishte reflektimi i atyre diskutimeve dhe vendimeve që u morën në dy seancat që u zhvilluan këtu në ad-hoc dhe detyra e tretë, ka qenë akomodimi i tri grupeve të vërejtjeve që erdhën nga zonja Hysi, zoti Vasili dhe EURALIUS-i. Pra detyra e parë ka qenë ajo. Ne jemi konfidentë që në projektin që ju do të merrni në **dispozicion**, kemi bërë një reflektim besnik të ndryshimeve kushtetuese.

Fatmir Xhafaj – Ka gjë tjetër?

Dakord, faleminderit për shtjellimin që i bëtë dhe për ekspozenë që paraqitët në reflektim të komenteve dhe të sugjerimeve të bëra nga kolegët Hysi dhe Vasili! Shpresoj që t'i kemi në dispozicion për të gjithë kolegët, në mënyrë që ata të jenë të mirinformuar dhe në funksion të nevojës për të debatuar ditën e hënë, kur do të duhet ta shqyrtojmë dhe ta miratojmë këtë projektligj, ashtu siç ramë dakord. Nga ana tjetër do të mendoja që, nëse është e mundur, edhe në kuadrin e frymës konstruktive, që edhe kolegët e PD-së të kenë mundësi që t'ia japin në kohë ekspertëve, ashtu siç kanë bërë kolegët e tjerë, do të ishte shumë pozitive dhe një frymë konstruktive pune. Ditën e hënë do të vazhdojmë mbi këtë bazë dhe ekspertët do të ndajnë përfundimisht opinionin e tyre dhe ne natyrisht, qëndrimin tonë.

Nesër në orën 9:00, mbledhje e komisionit për ligjin për SPAK-un.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA